

UDHËZIME PËR AUTORËT

Autori(ët) dërgojnë artikullin e plotë në adresën e redaksisë. Artikulli duhet të dërgohet në formë elektronike (me e-mail pranë redaksisë në adresën *buletinfshn@uoj.edu.al*). Artikulli duhet të shkruhet në gjuhë shqipe të saktë e të kuptueshme. Janë të pranueshme edhe dorëshkrime në gjuhën angleze të redaktuar më parë në përputhje me cilësinë e kërkuar gjuhësore.

Artikulli duhet të jetë i shkruar në MS Word dhe të mos ketë më shumë se 10 faqe sipas ndarjeve dhe formatimit të përshkruar më poshtë. Madhësia e letrës: A4; hapësirat boshe nga të gjitha anët: 4.5 cm; shkrimi: Times New Roman.

Artikulli duhet të formatohet sipas rubrikave dhe specifikimeve të mëposhtme:

Titulli: në qendër të rreshtit, shkronja kapitale, madhësi 12, të theksuara (bold). Mundësisht të shmangen nga titulli formulat matematike, simbolet, inicialet dhe shkurtime të frazave të caktuara.

Autori(ët): në një rresht, në qendër të rreshtit, shkronja kapitale, madhësi 12. Nuk duhen paraqitur grada, tituj, etj.

Adresa(at): përkatëse të autorit(ëve), në qendër të rreshtit, madhësi 11. Në rast bashkëautorësie, adresat përkatëse të institucionit (p.sh. Departamenti, Fakulteti, Universiteti, Instituti, etj.), shkruhen në rreshta të veçantë. Adresa e e-mailit të autorit që mban lidhje me redaksinë është e detyrueshme.

Përmbledhja (shqip) dhe **Abstrakti** (anglisht): shkrimi 11, i pjerrët (italic), vijëzimi justified, hapësira midis rreshtave single. Abstrakti duhet të ketë jo më shumë se 200 fjalë. Rekomandohet të mos citohen burime të literaturës.

Fjalët kyçe / Key words: (4-6 të tilla), shkrimi 11, i pjerrët (italic), vijëzimi justified.

Titujt e gjithë rubrikave (“Hyrje”, “Metodat dhe materialet”, “Rezultatet”, “Përfundime dhe/ose Diskutime”), duhet të shkruhen me shkronja kapitale, me madhësi 12, të theksuara (bold), vendosur majtas rreshtit. Përmbajtja e tyre duhet të shkruhet me madhësi 11, vijëzimi justified, hapësira midis rreshtave 1,5.

Falenderime: shkrimi 10, vijëzimi justified, hapësira midis rreshtave 1,5. Nëse përdoret (por jo domosdoshmërisht), në këtë ndarje autori(ët), në gjykimin e

tyre, falenderojnë gjithë ata që nuk janë përfshirë në masën e autorësisë për kryerjen e studimit, (p.sh. kontribut në grumbullimin ose analizën e të dhënave, redaktimin gjuhësor, etj.). Mund të përmenden gjithashtu burimet e financimit (p.sh. projekti, donatori, etj.) për studimin e përshkruar.

Referenca: shkrimi 10, vijëzimi justified, hapësira midis rreshtave 1,5. Citimi i literaturës në tekst/trup duhet të bëhet në përputhje me stilin APA (shiko www.apastyle.org), duke vendosur mbiemrin e autorit të parë të referencës pasuar me vitin e botimit, p.sh. (Jones, 2012). Përdoruesit e MS Word 2007 (dhe më vonë) mund të shfrytëzojnë komandën përkatëse në menunë "References". Çdo referencë e listës "literatura" duhet të citohet në tekst dhe anasjelltas. Citimet në "abstrakt" rekomandohet të shmangen. Mund të përmenden në tekst, por nuk duhen përfshirë në listën e referencave rezultate të pa publikuara. Citimi i një burimi literature si "në shtyp" nënkupton se është pranuar për botim. Referencat duhet të renditen fillimisht alfabetikisht dhe pastaj (nëse është e nevojshme) kronologjikisht.

Figurat, (foto, harta, grafikë, etj.) dhe tabelat, duhet të jenë të qarta dhe me përmasa që nuk i kalojnë përmasat e faqes së shtypur (12x21cm) dhe të vendosura në qendër të rreshtit. Ato duhet të vendosen pranë paragrafit ku përmenden në material. Formulatat matematike duhet të jenë të shkruara qartë me simbole të pajtueshme për të mos krijuar keq interpretime. Emrat latinë të gjallesave duhet të shkruhen saktë me shkronja të pjerrëta (italike).

Legjendat e figurave, të numëruara në mënyrë të njëpasnjëshme, duhet të shkruhen me shkronja të theksuara (bold), me madhësi 10, vendosur poshtë figurës dhe në qendër të rreshtit.

Legjendat e tabelave, të numëruara në mënyrë të njëpasnjëshme, duhet të shkruhen me shkronja të theksuara (bold), me madhësi 10, vendosur lart tabelës dhe majtas rreshtit.

Në Buletin mund të publikohen informacione përmbledhëse në më pak se 4 (katër) faqe si: *Përmbledhje libri*, *Informacion mbi projekte shkencore*, etj. të cilat duhet të përgatiten me kujdes të veçantë.

Vetëm artikujt e plotë sipas formatimit të kërkuar, të dorëzuar në afatet e përcaktuar nga Redaksia, do të pranohen. Redaksia rezervon të drejtën e kthimit të punimit tek autori për ta përshtatur në formatimin e kërkuar për artikujt që nuk janë të tillë.

Punimet diskutohen në mbledhje të Redaksisë dhe u jepen recensuesve anonimë, të cilët japin mendim me shkrim për cilësinë e punimit. Autori përgjegjës informohet nga Redaksia për rezultatin e recensës si dhe për përmirësimet e mundshme sipas sygjërimeve të recensuesit. Të gjitha përgjegjësitë lidhur me përmbajtjen dhe origjinalitetin e punimit i mban autori. Pas botimit çdo autor merr një kopje të periodikut ku ka publikuar punimin e tij.

Shembuj për mënyrën e shkrimit të referencave sipas stilit APA:

- ***Shembuj referimi ndaj një publikimi në një periodik (revistë) shkencor:***

Gersch, J., Hanrad, A., & Lupton R. (2000). The art of writing a scientific article. *Journal of Scientific Communications*, 163, 51-59.

Allen, M. (1995). The future of higher education in Australia. *Journal of Higher Education*, 15(2), 16-25.

- ***Shembuj referimi ndaj një libri:***

Back, W., & White, B. (1999). *Physics for scientists and engineers. (3rd ed.)*. New York: Macmillan, (Chapter 4).

- ***Shembull referimi ndaj një libri (me një organizatë si autor):***

Department of Health Services. (2007). *Youth suicide in Australia: The National Youth Suicide. Prevention Strategy*. Canberra, ACT: AGPS.

- ***Shembull referimi ndaj një Proceeding të një Konferencë***

Prayag, L., & Smithson, R. (2009). The impact of Newcastle disease control on smallholder poultry production. In R.G. Alsters, & M.P. Young (Eds.), *The sustainable control of Newcastle disease: Proceedings of international conference held in Canberra, Australia, 5-7 October 2005* (pp. 132-134). Canberra, Australian Centre for Agricultural Research.

- ***Shembull referimi ndaj një përmbledhjeje punimesh shkencore:***

Mettam, G., & Adams, L. (1994). How to prepare an electronic version of your article. In B. Jones, & Z. Smith (Eds.), *Introduction to the electronic age* (pp. 281-304). New York: E-Publishing Inc.

- ***Shembull referimi ndaj një gazete (versioni i printuar):***

Gordon, M. (2011, August 20). The invention that changed it all. *The Times*, pp. 18, 22.

- ***Shembull referimi ndaj një gazete (versioni online):***

Norton, A. (2011, October 11). Why teaching must be rated. *The Times*. Marrë nga <http://www.thetimes.com>

- ***Shembuj referimi ndaj një burimi në internet:***

Allen, D. (2004). *Dealing with your meeting notes*. Marrë nga <http://www.effectivemeetings.com/meetingbasics/>

The Australian Psychological Society. (2008). *Understanding and managing anxiety*. Marrë nga <http://www.psychology.org.au/publications/anxiety>